



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 3804 Prot.

Tiranë, më 26 . 06 . 2023

UDHËZIM

Nr. 11 , datë 26.06 . 2023

PËR

NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 05.07.2022 “PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4, të nenit 48, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar, pas nenit 9/2, të shtohet neni 9/3 me përmbajtje, si më poshtë:

Neni 9/3

“Vlerësimi i nxënësve në institucionet e arsimit special”

1. *Në institucionet e arsimit special të nxënësve që nuk dëgjojnë, vlerësimi në klasat 1-9 për të gjitha lëndët mësimore dhe modulet profesionale bëhet sipas këtij udhëzimi, me përjashtim të lëndëve speciale për klasat 1-3, për të cilat vlerësimi bëhet për lëndë dhe në kolonën e kompetencave vendoset vetëm emërtimi i lëndës. Në institucionet e arsimit special për nxënësit që nuk dëgjojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe në lëndën e gjuhës angleze, në klasat 1-3 hiqet kompetenca e të dëgjuarit.*
2. *Në institucionet e arsimit special të nxënësve që nuk shikojnë, vlerësimi në klasat 1-9 për të gjitha lëndët mësimore bëhet sipas këtij udhëzimi, me përjashtim të lëndëve speciale për klasat 1-3, për të cilat vlerësimi bëhet për lëndë dhe në kolonën e kompetencave vendoset vetëm emërtimi i lëndës.*

3. Në institucionet e tjera të arsimit special, përveç atyre të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, vlerësimi bëhet si më poshtë:

- a) Në përfundim të çdo periudhe, në çdo lëndë mësimore, nxënësit vlerësohen me fjalë dhe shprehje në klasat 1-3 dhe me një notë në klasat 4-9. Ky vlerësim është rezultat i të gjitha vlerësimeve/notave që nxënësi ka marrë gjatë periudhës në lëndën përkatëse.
- b) Numri i notave në çdo lëndë mësimore për një periudhë është sipas këtij udhëzimi.
- c) Vlerësimi përfundimtar vjetor (nota vjetore) në çdo lëndë mësimore është rezultat i tri vlerësimeve/notave të periudhave.
- d) Për përcaktimin e vlerësimit të periudhave dhe vlerësimit përfundimtar mësuesi duhet të marrë në konsideratë progresin e nxënësve.
- e) Dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit për lëndët mësimore është si në tabelën më poshtë:

Periudha e parë	Periudha e dytë	Periudha e tretë	Vlerësimi përfundimtar
- Vlerësim me fjalë e shprehje në klasat 1-3.	- Vlerësim me fjalë e shprehje në klasat 1-3.	- Vlerësim me fjalë e shprehje në klasat 1-3.	- Vlerësim me fjalë e shprehje në klasat 1-3.
- Vlerësim me notë në klasat 4-9.	- Vlerësim me notë në klasat 4-9.	- Vlerësim me notë në klasat 4-9.	- Vlerësim me notë në klasat 4-9.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTËR

EVIS KUSHI

